



LeTSGEP-të [ojnë drejt planeve të qëndrueshme të barazisë gjinore në organizatat që kryejnë kërkime

Ky projekt ka marrë financim nga programi i Kërkimit dhe Inovacionit Horizon 2020 i Bashkimit Evropian sipas Marrëveshjes së Grantit nr. 873072



LeTSGEPs

**Programi i Trajnimit LeTSGEPs mbi Barazinë Gjinore,
Planet e Barazisë Gjinore dhe Buxhetimin Gjinor**

**Materialet e trajnimit
për partnerët zbatues**

Gjinia

- ❖ E strukturuar nga shoqëria
- ❖ Mësohet përmes proceseve të shoqërizimit
- ❖ Specifike sipas kontekstit dhe kohës
- ❖ E ndryshueshme
- ❖ Pjesë e kontekstit më të gjerë socio-kulturor

Ndërlidhja gjinore

«Gjinia është hierarkike dhe prodhon pabarazi që ndërlidhen me pabarazitë e tjera shoqërore dhe ekonomike.

Diskriminimi me bazë gjinore ndërlidhet me faktorë të tjerë të diskriminimit, siç janë etnia, statusi socio-ekonomik, aftësia e kufizuar, mosha, vendndodhja gjeografike, identiteti gjinor dhe orientimi seksual, ndër të tjera.

Kësaj i referohemi si ndërlidhje.»

Stereotipet gjinore

”.. Stereotipet gjinore janë (në fakt) ide të paracaktuara ku meshkujve dhe femrave u caktohen në mënyrë arbitrare karakteristika dhe role të përcaktuara dhe të kufizuara nga gjinia e tyre. Stereotipet seksuale mund të kufizojnë zhvillimin e talenteve dhe aftësive natyrore të djemve dhe vajzave, grave dhe burrave, përvojat e tyre arsimore dhe profesionale, si dhe mundësitë e jetës në përgjithësi. Stereotipet për gratë rezultojnë dhe janë shkak i qëndrimeve, vlerave, normave dhe paragjytimeve të rrënjosura thellë ndaj grave. Ato përdoren për të justifikuar dhe ruajtur marrëdhëniet historike të pushtetit të burrave mbi gratë, si dhe qëndrimet seksiste të cilat pengojnë përparimin e grave ...” (EIGE, 2020, fq.1).

Barazia Gjinore

“... i referohet **të drejtave, përgjegjësive dhe mundësive të barabarta** të grave dhe burrave, vajzave dhe djemve. Barazia nuk do të thotë që gratë dhe burrat do të bëhen të njëjtë, por që të drejtat, përgjegjësitë dhe mundësitë e grave dhe burrave nuk do të varen nga fakti nëse ata janë të lindur mashkull apo femër. Barazia gjinore nënkupton që interesat, nevojat dhe përparësitë e grave dhe burrave merren parasysh, duke **njohur diversitetin** e grupeve të ndryshme të grave dhe burrave. Barazia gjinore nuk është çështje e grave, por duhet të shqetësojë dhe angazhojë plotësisht burrat, si dhe gratë. Barazia midis grave dhe burrave shihet si **çështje e të drejtave të njeriut** dhe si parakusht dhe tregues i **zhvillimit të qëndrueshëm** me fokus te njerëzit ... ”(EIGE, 2020, p.1).

Integrimi gjinor

"... Shqyrtimi sistematik i dallimeve midis kushteve, situatave dhe nevojave të grave dhe burrave në të gjitha politikat dhe veprimet e Komunitetit. Integrimi gjinor është (ri)organizimi, përmirësimi, zhvillimi dhe vlerësimi i proceseve të politikave, në mënyrë që perspektiva e barazisë gjinore të përfshihet në të gjitha politikat, në të gjitha nivelet dhe të gjitha fazat, nga aktorët që normalisht përfshihen në politikëbërje. Përfshirja e perspektivës gjinore është procesi i vlerësimit të implikimeve që ka për gratë dhe burrat çdo veprim i planifikuar, përfshirë legjislacionin, politikat ose programet, në të gjitha fushat dhe në të gjitha nivelet. Është një mënyrë për t'i futur shqetësimet dhe përvojat e grave si dhe të burrave në një dimension përfshirës të hartimit, zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit të politikave dhe programeve në të gjitha sferat politike, ekonomike dhe shoqërore, në mënyrë që gratë dhe burrat të përfitojnë në mënyrë të barabartë dhe pabarazia të mos përjetësohet. Qëllimi përfundimtar është arritja e barazisë gjinore..."(EIGE, 2020, fq.1).

Buxhetimi gjinor

Buxhetimi gjinor mund të shihet si strategji për të zbatuar integrimin gjinor në procesin buxhetor

Stereotipet gjinore në BE



What Europeans have to say about gender stereotypes

44%

SOME EUROPEANS
THINK THAT...
(% AGREE)

... it is acceptable for men to cry



88%

... the most important role of a man is to earn money



43%

47% of men



41% of women

of Europeans think that the most important role of a woman is to take care of her home and family

43% of men



44% of women



69%

... women are more likely than men to make decisions based on their emotions

67% of men




71% of women

Stereotipet gjinore mund të vërehen në arsimin e lartë si dhe kërkimin shkencor

- ❖ stereotipet gjinore si pengesë për arritjen e barazisë më të madhe gjinore.
- ❖ në moshën 15 vjeç, djemtë dhe vajzat pritet të ndjekin karrierën në fusha stereotipe specifike për gjininë, pavarësisht nga lëndët në të cilat ata janë të aftë (OECD, 2017)
- ❖ është provuar se stereotipet e paracaktuara në shkencë pengojnë vetë-identifikimin e grave të reja me lëndë dhe fusha akademike STIM dhe gjithashtu ndikojnë negativisht në vetë-konceptimin dhe interesat e tyre mbi lëndët. Këto, nga ana tjetër, i pengojnë studentet femra të zgjedhin degët shkencore dhe të vazhdojnë karrierë në shkencë.
- ❖ gratë e reja nuk janë të përfaqësuara mjaftueshëm në shkencë, teknologji, inxhinieri dhe matematikë (STIM). Gratë përbëjnë më pak se 20% të aplikantëve në programet e nivelit të arsimit të lartë në shkenca kompjuterike në vendet e OECD dhe vetëm rreth 18% të aplikantëve inxhinierikë. OECD (2017).


Ndjekja e barazisë gjinore: një betejë e vështirë. Paris: Botimi i OECD.

Si është Barazia Gjinore sot në botë?



HENDEKU I PËRGJITHSHËM GJINOR: Duke pasur parasysh 100% të nivelit të plotë të barazisë gjinore në nivel global, Indeksi i Pabarazisë Gjinore i Kombeve të Bashkuara shënon 56,1% (2018), Indeksi Botëror i Hendekut Gjinor tregon 68,6% (2020), OZHQ-të (Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm) Indeksi i Barazisë Gjinore shënon 65,7% (2019).

Si është Barazia Gjinore sot në Evropë?



HENDEKU GJINOR në Evropë: Evropa është gjithmonë ndër rajonet me indekset më të larta në botë. Me ritmin aktual bota mund të arrijë barazinë e plotë gjinore brenda 99,5 vjetësh, Evropa Perëndimore për 54,4 vjet, për 59 vjet në Amerikën Latine dhe Karaibet, për 71 vjet e gjysmë në Azinë Jugore, për 95 vjet në Afrikën Sub-Sahariane, për 107 vjet në Evropën Lindore dhe Azinë Qendrore, për 140 vjet në Lindjen e Mesme dhe Afrikën Veriore, për 151 vjet në Amerikë e Veriut dhe për 163 vjet në Azinë Lindore dhe Paqësor.

Si paraqitet Barazia Gjinore në fushat kryesore?


Indeksi Botëror i Hendekut Gjinator

Nën-indeksi i Shëndetit dhe Mbijetesës

Nën-indeksi i Arritjes Arsimore

Nën-indeksi i Pjesëmarrjes dhe Mundësive Ekonomike

Nën-indeksi i Fuqizimit Politik



Nën-indeksi i HENDEKUT GJINOR:

Duke marrë parasysh katër nën-indeksat e Indeksit botëror të Hendekut Gjinator 2020, hendeku gjinor është pothuajse i mbyllur në nivel botëror në zonat që sigurojnë aktivitete riprodhimi dhe përkujdesjeje **si Shëndeti dhe Mbijetesë** (i mbyllur me 95,7%) dhe **Arritja Arsimore (96,1%)**, ndërsa fushat më afër aktiviteteve që kanë të bëjnë me prodhimin ende kanë rrugë të gjatë për të arritur barazinë gjinore: hendeku është mbyllur vetëm me 58,8% në nën-indeksin **e Pjesëmarrjes dhe Mundësive Ekonomike** dhe me 24,7% për nën-indeksin **e Fuqizimit Politik**.

Barazia gjinore në BE: punë shtëpiake

**Punë
shtëpiake:**

- 22 orë në javë punojnë gratë vs 9 orë burrat
- 80% e përkujdesjes ofrohet në mënyrë informale, 75% e tyre janë gra.



Barazia gjinore në BE: Tregu i punës

Hendeku gjinor në Tregun e Punës

- +11,6% është diferenca midis shkallës të punësimit të grave dhe burrave në BE
- Gratë përbëjnë 10% të punëtorëve të ndërtimit, 25% të bujqësisë, pyjeve, peshkimit dhe transportit
- Burrat përbëjnë 25% të punonjësve në arsim dhe 20% të punonjësve në aktivitetet shëndetësore dhe shoqërore



Barazia Gjimore në BE: Ndarja në Arsim

Ndarja gjimore në arsim dhe punë

- Ne vendet e Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD), 1 në 4 studentë me performancë të lartë në STIM pritet të vazhdojnë karrierën si inxhinierë ose shkencëtarë, kurse gratë, 1 në 6
- 1 në 3 vajza pritet të punojë si profesioniste e shëndetit, për djemtë raporti është 1 në 8
- Raporti i burrave që punojnë në sektorin digjital është 3, 1 herë më shumë se i grave.
- Vetëm 22% e programuesve të IA janë gra



Barazia Gjimore në BE: Hendeku Gjiner i Pagave

Hendeku gjiner
në pagë

- 15.7% Hendeku gjiner në pagë në BE
- 30.1% Hendeku gjiner në pensione në BE



Barazia Gjinore në BE: Vendimmarrja dhe politikat

Hendeku gjinor në
vendimmarrje dhe
politika

- Gratë përbëjnë 7.5% të Kryesuesve të Bordeve dhe 7.7% të Drejtorëve Ekzekutivë në listën e kompanive më të mëdha të BE.
- 32.2% e deputetëve të parlamenteve kombëtare në BE janë gra



Barazia gjinore në BE: Dhuna kundër grave


Dhuna ndaj grave

- 33% e grave në BE kanë përjetuar dhunë fizike dhe/ose seksuale
- 22% e grave në BE kanë përjetuar dhunë nga një partner intim
- 55% e grave në BE janë ngacmuar seksualisht




BGJ në Kërkime Shkencore: Të diplomuar në doktoraturë dhe punë në Sh&T


Gratë kanë arritur 47,9% të të diplomuarve të doktoratës në nivel BE në 2016, 68% të diplomuarve të doktoratës në arsim, 21% në teknologjitë e informacionit dhe komunikimit dhe 29% në TIK.




Profesionistë dhe teknikë



Shkencëtarë ose inxhinierë




BGJ në Kërkimet Shkencore: Studiuesit



Kushtet e ndryshme të punës të studiuesve dëshmojnë një prani më të lartë të grave mes punonjësve me kohë të pjeshme (13% e grave dhe 8% e burrave) dhe në "punësimin e pasigurt" (8,1% të grave dhe 5,2% të burrave), ndërsa hendeuku gjinor i pagave ka arritur në 17% të pagës më të ulët të grave në krahasim me burrat (2014).

BGJ në Kërkime Shkencore: Karriera akademike





Në STIM (shkencë, teknologji, inxhinieri dhe matematikë) hendeku i karrierës midis burrave dhe grave është edhe më i madh: gratë përfaqësojnë 37% të studentëve të doktoratës, 39% e të diplomuarve të doktoratës 15% të pozicioneve akademike të klasës A.

Hendeku i karrierës gjithashtu ndikon në pjesëmarrjen e grave në vendimmarrje: në vitin 2017 në BE gratë përbënin 22% të drejtuesve të institucioneve në sektorin e arsimit të lartë, 27% të anëtarëve të bordeve të organizatave kërkimore dhe 20% vetëm të drejtuesve të bordeve

BGJ në Kërkime Shkencore: Rezultatet

Botime në të gjitha fushat e Kërkimit&Zhvillimit



Hendeku gjinor domethënës përcakton gjithashtu rezultatet e kërkimit dhe inovacionit, pasi, midis viteve 2013 dhe 2017, vetëm **32% e botimeve në të gjitha fushat e K&ZH të kombinuara janë nga gra**, me përqendrim më të lartë në fushat e shkencave mjekësore dhe bujqësore. Mes **shpikësve që përftojnë patenta**, raporti gra me burra është mesatarisht pak më shumë se një me tre, ndërsa shkalla e suksesit të financimit në marrjen e **granteve kërkimore** është më e lartë te drejtuesit meshkuj të ekipeve me 3%.

Sistemi patriarkal deri në shekullin e 18-të



BURRAT: Mbizotëronin dimensionin publik duke mbajtur pushtetin parësor mbi burimet, pronën, punën e paguar, drejtimin politik dhe autoritetin moral.

GRATË: prej tyre pritej të përmbushnin të gjitha kërkesat e dimensionit privat, duke u kujdesur për fëmijët dhe të moshuarit, duke bërë punët e shtëpisë.

Asnjë kontroll mbi trupat e tyre ose lindjet,

Asnjë reagim ndaj dhunës së burrave

Asnjë pronë private ose trashëgimi,


Asnjë e drejtë civile, asnjë votë

Pa arsim

Paguheshin minimalisht për punë jashtë familjes



Revolucioni Industrial shekulli i 18-19-të




- Rritja tronditëse industriale dhe ekonomike,
 - Sistemi i ri kapitalist
 - Ndryshimet shoqërore: eksod nga jeta rurale dhe urbanizim intensiv.
 - Njerëzit e klasës punëtore ishin të paguar shumë pak (gratë edhe më pak se burrat) dhe me kushte shumë të vështira dhe jo të shëndetshme pune
 - Protestat dhe lufta e punëtorëve për më shumë të drejta të barabarta,
 - Ngritja e lëvizjeve politike të frymëzuara nga Marksizmi dhe Socializmi.
-
- **GRATË:**
 - treg i punës të paguar në masë në punët e fabrikës duke zëvendësuar punët e tyre tradicionale në shtëpi (p.sh. tekstile ose industri ushqimore).
 - punët e shtëpisë u rritën për të kënaqur nevojat e familjeve që punonin
 - Ndërgjegjësim i ri mbi statusin dhe të drejtat e punës

Vala e Parë e Feminizmit: Protestueset për të drejtën e votës



Vala e parë e Feminizmit, në shekullin XIX dhe XX u përqendrua në përmbysjen e pabarazive ligjore, kryesisht në të drejtën e votës së grave. Lëvizja *Suffragettes* filloi në 1886-1887 dhe luftoi për të drejtat e grave për të votuar. Vendi i parë që pranoi të drejtën e votës universale për burrat dhe gratë ishte Zelanda e Re në 1893, pastaj Australia pasoi në 1902, Mbretëria e Bashkuar në 1918, Shtetet e Bashkuara në 1920.



Lufta e Dytë Botërore:




Gjatë Luftës së Parë dhe mbi të gjitha, gjatë Luftës së Dytë Botërore:

- shumë gra hynë në tregun e punës, shpesh duke zëvendësuar burrin në linjë në industrinë e luftës
- morën pjesë në luftë si partizanë në disa vende ose në shërbimin ushtarak jo luftarak në disa vende të tjera.

Pavarësisht se pas luftës shumë gra u kthyen në punët e familjes, vetëdija e tyre shoqërore dhe ndjenja e qytetarisë u rrit më tej, si dhe angazhimi i tyre në beteja politike dhe sociale për më shumë barazi gjinore në më shumë fusha.



Vala e dytë e Feminizmit:



Vala e Dytë e FEMINIZMIT (1960-1980) debati i zgjeruar për të ndryshuar rolet tradicionale gjinore në një model më të barabartë, duke fuqizuar ndjeshëm rolin e grave në shoqëri, në politikë dhe në ekonomi. Shumica e vendeve perëndimore miratuan ligje të rëndësishme për barazinë gjinore në punë, në familje, prezantuan divorcin dhe mundësinë e abortit. Të drejtat shoqërore, familjare dhe të njeriut u zhvilluan paralelisht me rritjen e numrit të grave në tregun e punës dhe patën përparim të madh në të drejtat e familjes, pabarazitë kulturore, normat gjinore dhe rolin e grave në shoqëri.

Vala e tretë e Feminizmit :



Nga vitet 1990 deri në 2000:
Globalizimi, konsumerizmi,
sistemi neo-liberal dhe ekonomia
kapitaliste mbarëbotërore.

Gratë:

Qasja individualiste ndaj
feminizmit, e zhvilluar kryesisht
në nivel personal në fuqizimin e
karrierës së grave.


Në nivel teorik, është identifikuar
gjithashtu vala e tretë e
feminizmit, duke filluar nga vitet
1990, me fokus kryesisht në
kritikat ndaj valës së dytë dhe në
një interpretim post-strukturalist
të gjinisë dhe seksualitetit si
jashtë gjinisë binare mashkull-
femër, përveç kryqëzimit midis
racës dhe gjinisë.

Historia e grave në shkencë(1):



Transkriptim mesjetar i Elementeve të Euklidit (rreth 1310 pas Krishtit) që paraqet Gruan që jep mësim gjeometrinë

- Në qytetërimet e hershme gratë ishin të përfshira në fushën e mjekësisë
- Në Greqinë e lashtë gratë mund të studionin filozofinë natyrore
- Në shekullin 1 dhe 2 pas Krishtit gratë ishin aktive në studimin e proto-shkencës së alkemisë
- Në Mesjetë gratë mund të studionin dhe zhvillonin talentet e tyre kërkimore dhe shkencore kryesisht në manastire fetare
- Në shekullin e 11 -të u shfaqën Universitetet moderne, por gratë u përjashtuan prej tyre



Hipatia nga Aleksandria

Historia e grave në shkencë(2):

- Në kohët e hershme moderne gratë bënë kërkime kryesisht në botanikë jashtë Akademisë
- Në 1678 Elena Lukrecia Kornaro Loredan Piskopia ishte gruaja e parë që u diplomua në botë (në filozofi)
- Në 1732 Laura Basi ishte gruaja e parë në botë që mori diplomë universitare në një fushë shkencore dhe ishte profesoresha e parë grua e fizikës
- Në gjysmën e parë të shekullit XIX gratë u përjashtuan nga shumica e arsimit shkencor
- Nga fundi i shekullit të 19-të gratë filluan të studionin në kolegjet e grave dhe filluan të kenë mundësi për kërkim shkencor




*Elena Lukrecia Kornaro
Loredan Piskopia*



Laura Basi

Gratë dhe Çmimi Nobel :



".. Çmimi Nobel dhe Çmimi në Shkencat Ekonomike u janë dhënë grave 58 herë midis viteve 1901 dhe 2020. Vetëm një grua, Mari Kyri, e ka marrë dy herë Çmimin Nobel, në Fizikë në 1903 dhe Çmimin Nobel në Kimi të vitit 1911. Kjo do të thotë që 57 gra në total kanë marrë Çmimin Nobel midis viteve 1901 dhe 2020 .. ", krahasuar me 873 burra

<https://www.nobelprize.org/prizes/facts/nobel-prize-facts/>

Konventat dhe traktatet ndërkombëtare për BGJ :

- Konventa për të Drejtat Politike të Grave (1954)
- Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Grave (CEDAW) (1979).
- Deklarata e Eliminimit të Dhunës ndaj Grave (1993)
- Deklarata e Pekinit dhe Platforma për Veprim (PFA) (1995)
- Konventa për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit) (2014)
- Marrëveshja e Parisit (sipas Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike) (2015)

- KATËR KONFERENCA BOTËRORE PËR GRATË organizuar nga Kombet e Bashkuara
 - 1975 Meksiko Siti,
 - 1980 Kopenhagen,
 - 1985 Nairobi,
 - 1995 Pekin

Platforma e Pekinit për veprim: Fuqizimi + Integrimi kryesor



Platforma e Pekinit për Veprim. 12 çështje të Fushave Kritike

- Gratë dhe varfëria
- Arsimimi dhe trajnimi i grave
- Gratë dhe shëndeti
- Dhuna ndaj grave
- Gratë dhe konfliktet e armatosura
- Gratë dhe ekonomia
- Gratë në pushtet dhe vendim-marrje
- Mekanizma institucionale për përparimin e grave
- Të drejtat e njeriut për gratë
- Gratë dhe media
- Gratë dhe mjedisi
- Fëmijët vajza

Konferenca e Katërt Botërore për Gratë e mbajtur në Pekin në 1995, me 17.000 pjesëmarrës, 30.000 aktivistë dhe 189 qeveri të përfshira, përfaqëson edhe sot një arritje në strategjitë dhe vizionin botëror të barazisë gjinore. Deklarata e Pekinit dhe Platforma për Veprim që u lançua në fund të Konferencës, përvijon kornizën e strategjisë botërore për barazinë gjinore që mbështetet në dy shtylla kryesore: integrimin gjinor dhe fuqizimin gjinor, ndërsa janë identifikuar dymbëdhjetë fusha kritike si prioritetet kryesore për ndërhyrje nga qeveritë.

Agjenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm: 17 Objektiva



Angazhimi i qeverive në mbarë botën për të çrrënjosur varfërinë dhe për të arritur zhvillimin e qëndrueshëm deri në vitin 2030. Ndër 17 Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) dhe 169 objektivat që do të arrihen deri në vitin 2030, Barazia Gjinore është përfshirë si Objektiv specifik (Objektivi nr. 5) dhe objektiv ndërsektorial në pikësynimet e tjera

Angazhimi i BE -së për Barazinë Gjinore

- ❖ Traktati i Romës (1957) për krijimin e Komunitetit Ekonomik Evropian, në Nenin 119 (tani Neni 141 Traktati i KE), për luftën ndaj diskriminimit gjinor dhe për të afirmuar parimin e pagës së barabartë midis burrave dhe grave për punë të barabartë.
- ❖ Aktiviteti intensiv i BE-së për legjislacionin për barazinë gjinore, kryesisht i miratuar nga ligjet e vendeve të BE-së, që kanë të bëjnë me çështjet e barazisë gjinore si siguria shoqërore, siguria dhe shëndeti në punë i punonjëseve shtatzëna, punësimi dhe profesioni, ngacmimi seksual, leja prindërore, vetëpunësimi, trafikimi i qenieve njerëzore, të drejtat, mbështetja dhe mbrojtja e viktimave të krimit.
- ❖ vendimet e Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian kanë qenë të rëndësishme për të promovuar barazinë midis burrave dhe grave
- ❖ Konventa për parandalimin dhe luftën ndaj dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit, 2014), instrumenti i parë ligjor i detyrueshëm ndërkombëtar për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe vajzave në nivel ndërkombëtar

Angazhimi i BE-së për Barazinë Gjinore: Strategjia e Re e Barazisë Gjinore 2020-2025

Strategjia e Re e Barazisë Gjinore 2020-2025 përvijoi shtyllat kryesore të veprimit të BE-së për të ardhmen e afërt duke përqafuar plotësisht arritjen e objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe duke u fokusuar në mundësitë e barabarta për gratë dhe burrat si mjeti për t'i dhënë vlerë diversiteteve dhe për të ndjekur rritjen ekonomike dhe sociale të BE-së.

Komisioni Evropian (2020). Komunikim nga komisioni në Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetin Evropian ekonomik dhe social dhe Komitetin e Rajoneve

Strategjia e Re e Barazisë Gjinore 2020-2025 miraton qasjet e mëposhtme

1. Integrimi gjinor, ku përfshihet perspektiva gjinore në të gjitha fushat e politikave, në të gjitha nivelet dhe në të gjitha fazat,
2. Kryqëzimi, duke u përballur me diskriminimet e shumta që gratë përjetojnë në bazë të karakteristikave të tyre personale si raca, aftësitë e kufizuara, orientimi seksual, mosha etj.
3. Financim i përkushtuar duke siguruar burime të veçanta për projekte të lidhura me barazinë gjinore të financuara nga shumica e programeve të BE-së.

Strategjia e Komisionit Evropian për barazinë gjinore në objektivat kryesore të politikës së kërkimit dhe inovacionit

- ❖ Nxitja e barazisë në karrierën shkencore;
- ❖ Sigurimi i baraspeshës gjinore në proceset dhe organet vendimmarrëse;
- ❖ Integrimi i dimensionit gjinor në përmbajtjen e kërkimit dhe inovacionit

Strategjia e BE-së për Barazi Gjinore 2020-2025 & PSAG (Politikat sociale, të Arsimit dhe Globalizimit)

Në fushën e kërkimit dhe inovacionit, Komisioni prezantoi masa të reja për të forcuar barazinë gjinore në Horizon Europe, si p.sh

- **kërkesa e një plani të barazisë gjinore** (në rast se propozimi zgjidhet për financim, të pasurit e një Plani për Barazi Gjinore (me kërkesat minimale) është i nevojshëm para nënshkrimit të grantit),
- iniciativa për të rritur numrin e kompanive të reja të teknologjisë të drejtuara nga gratë,
- Do të vihet gjithashtu në dispozicion financimi për kërkimin gjinor dhe kryqëzues.

Çfarë është Buxhetimi Gjinator



Objektivi kryesor i Buxhetimit Gjinator është **barazia gjinore**.

“... Buxhetimi gjinator është zbatimi i **integritit gjinator** në **procesin buxhetor**. Ka të bëjë me vlerësimin e buxheteve bazuar në gjini, ku përfshihet perspektiva gjinore në të gjitha nivelet e procesit buxhetor dhe ristrukturimin e të ardhurave dhe shpenzimeve me qëllim promovimin e barazisë gjinore...”
“(Këshilli i Evropës, 2005, f. 10).

PSE duhet Buxhetimi Gjinator?



Qëllimi kryesor:
futja e barazisë gjinore në procesin buxhetor.

Arsyet specifike:

- vendimet në lidhje me arsimin, karrierën, punën, jetën e njerëzve, por edhe mirëqenien dhe të drejtat nuk mund të zbatohen pa alokimin e duhur të burimeve. **Paraja është faktori kryesor kyç për t'i shndërruar vendimet në realitet** dhe një zbulues i së vërtetës mbi synimet e vërteta të vendimmarrësve.
- **buxheti nuk është mjet neutral**, por reflekton shpërndarjen ekzistuese të pushtetit brenda shoqërisë midis grave dhe burrave. Cikli dhe procesi buxhetor janë strukturuar kryesisht nga burrat, duke shprehur kështu shkallën e vlerave, parimet, çështjet kryesore dhe prioritetet e burrave.

PSE duhet Buxhetim Gjinator në OPK?

Buxhetimi gjinator ofron:

një mjet vetë-vlerësimi për OPK-të dhe Institucionet për të përmirësuar ndërgjegjësimin e tyre mbi ndikimin gjinator të vendimeve të tyre financiare,

ndërgjegjësim të profesorëve, studiuesve, studentëve dhe çdo aktori tjetër për vëmendjen e OPK -ve ndaj kësaj çështjeje.




Të qenit të vetëdijshëm për nivelin e ndikimit gjinator të buxheteve të OPK-ve është hapi i parë për të filluar një proces të hartimit të strategjive me ndjeshmëri ndaj gjinisë dhe për të zhvilluar potencialin dhe talentin e plotë të çdo personi të përfshirë në OPK në çdo nivel.

4 objektivat e Buxhetimit Gjinator (BGJ)



1. të promovojë **barazinë, efikasitetin dhe efektivitetin**, në planifikimin dhe zbatimin e politikave të OPK-ve;
2. të favorizojë **transparencën** në ndarjen dhe rishpërndarjen e burimeve publike;
3. të rrisë **ndërgjegjësimin** përmes informacionit dhe përfshirjes së palëve të interesuara;
4. të rrisë zhvillimin e **aftësive njerëzore** nga perspektiva e barazisë.

1. Të promovojë barazinë, efikasitetin dhe efektivitetin



- **Barazia:** Vëmendja ndaj buxhetimit, e cila i kushton njëloj vëmendje të gjithëve, garanton që barazia gjinore të jetë objektiv dhe tregues i politikave të OPK-së.
- **Efikasiteti:** Dallimet gjinore çojnë në humbje gjithnjë e më të mëdha në efikasitetin ekonomik dhe zhvillimin njerëzor, veçanërisht në vendimet e politikave që i referohen të ardhurave dhe shpenzimeve.
- **Efektiviteti:** I referohet aftësisë së politikave për të arritur rezultate. Në qasjen me ndjeshmëri ndaj gjinisë, vlerësohet aftësia politike për të kompensuar dallimet gjinore në lidhje me qëllimet fillestare.

2. Të favorizojë **transparencën** në ndarjen dhe rishpërndarjen e burimeve publike.



Ky objektivi identifikon, nga perspektiva gjinore, tendencën e përgjithshme për t'u **fokusuar te kontabiliteti**, duke kërkuar që të gjitha organet institucionale të **OPK-ve**, vendimmarrësit dhe administratorët, t'u **japin një raport të plotë mbi veprimet e tyre aktorëve**.

3. Të rrisë ndërgjegjësimin përmes informacionit dhe përfshirjes së aktorëve




- Transparenca në procesin e buxhetit mund të zhvillohet në mënyrën e duhur nëse mbështesim **procesin e pjesëmarrjes** për përfshirjen e aktorëve. Konsultimi publik ose pjesëmarrja e barabartë gjinore e aktorëve në procesin e buxhetimit, monitorimit dhe vlerësimit, mund të përfaqësojë një burim të rëndësishëm të barazisë gjinore edhe brenda OPK-ve.

4. Të rrisë zhvillimin e aftësive njerëzore nga perspektiva e barazisë (1).

“Zhvillimi duhet të fokusohet tek njerëzit, jo tek ekonomia”

Një jetë e mirë konsiston në faktin që një person mund të funksionojë jo vetëm në aspektin biologjik, por edhe në aspektin e ushtrimit të zgjedhjes dhe arsyes Aristoteli



Teoria e aftësive nuk i kushton rëndësi artikujve të përdorimit të gjerë ose kënaqësisë që merr dikush prej tyre; ajo e vë theksin te mundësitë e njerëzve për t'i përdorur ato për të arritur mirëqenien.



Qasja e Aftësive

Aftësitë janë liritë e pavarura që një person i gëzon për të bërë atë lloj jete që ai e gjykon me vlerë.

Duke investuar në njerëz, ne mundësojmë rritjen dhe fuqizimin e tyre për të ndjekur drejtime të ndryshme në jetë, dhe si rrjedhim zhvillojmë aftësitë njerëzore.

Aftësitë më kryesore për zhvillimin e një personi janë: të jetojë një jetë të gjatë dhe të shëndetshme, të jetë i ditur (i arsimuar), të ketë akses në burimet dhe shërbimet sociale që nevojiten për një standard dinjitoz jetese dhe të jetë në gjendje të marrë pjesë në jetën e komunitetit.

Funksionimet dhe Aftësitë


Funksionimi është ajo çka bën një person me artikujt e përdorimit të gjerë me karakteristika të caktuara. Reflekton “të bërit” dhe “të qenit” të ndryshme.

Aftësia nënkupton lirinë që ka një person në zgjedhjen e funksioneve.

Si përfundim, është aftësia për të funksionuar ajo që ka më shumë rëndësi në fund të fundit.



4. Të rrisë zhvillimin e aftësive njerëzore nga perspektiva e barazisë (2).



Qasja e Aftësive kapërcen kufijtë e metodologjive të buxhetimit gjinor të bazuar në performancë, të fokusuar në përdorimin e burimeve publike dhe në efikasitetin e politikave të analizuara, por duke përjashtuar ekonominë e kujdesit. Qasja e Aftësive analizon veprimin e OPK-ve jo vetëm sipas aftësisë së tyre për të ofruar shërbime për gratë dhe burrat, por edhe për rolin e tyre në zhvillimin e dimensioneve të mirëqenies.

Historia e Buxhetimit Gjiner




☒ Mesi i viteve 1980-të - Eksperimentimi i parë nga Qeveria Australiane, pastaj MB-ja në 1989, Kanadaja në 1993, Afrika e Jugut në 1996

- ☒ 1995 BGJ u përfshi në Platformën e Pekinit për Veprim
- ☒ 1996 Projekti i NGJ-së i Sekretariatit të Komënuelthit
- ☒ 2001 Programi global i Iniciativave Buxhetore Sipas Gjinisë nga UNIFEM dhe IDRC


BGJ është zhvilluar në 84 vende në nivel kombëtar (FMI, 2015), dhe nga 41% e vendeve të OECD-së (Downes et al., 2017).

Buxhetimi Gjinator në BE



- Programi i Veprimit Final 1996 COM (1996) 63 - për promovimin e mundësive të barabarta midis grave dhe burrave,
- Përfshirë në Kornizën e Strategjive të Veprimit për Mundësi të Barabarta për vitet 2001-2005 në vitin. 2019
- 2001- Konferenca e parë e BE-së për "Buxhetimin Sipas Gjinisë"
- 2003 - Rezoluta e Parlamentit Evropian mbi Mundësitë e Barabarta për Gratë dhe Burrat 1.3.30. për "Buxhetimin gjinator - Ndërtimi i buxheteve publike nga perspektiva gjinore"
- BGJ rekomandohet gjithashtu në rezolutat që lidhen me drejtësinë klimatike, varfërinë, epokën digjitale, krizën ekonomike
- 2015 - "Buxheti i BE -së për Barazinë Gjinore", përditësuar në 2019

Analiza e Zhvillimeve të Fundit të BGJ




88% e BGJ -ve të analizuara nuk ndjekin ndonjë udhëzim standard të saktë

Metodologjitë më të aplikuara në BGJ-të e shqyrtuara janë:

1. MFP (Menaxhimi i Financave Publike)
2. QBLL (Qasja e Bazuar në Llogari).
3. BGJM (Buxhetet Gjinore të Mirëqenies);
4. BP (Buxheti me Pjesëmarrje);
5. BBP (Buxhetimi i Bazuar në Performancë ose buxhetimi i bazuar në rezultate);
6. QGJGJ (Qasje më e Gjerë Gjinore).

Hapat e Procesit të BGJ-së



BGGJ-ja dhe PBGGJ-ja

Cikli i analizës së PBGGJ-së përkon kryesisht me ciklin e procesit të Buxhetimit Gjinator.

Dallimi mbështetet në theksin e ndryshëm dhe analizën e thelluar që Buxhetimi Gjinator identifikon në ndikimin gjinator të fazës së alokimit të burimeve.

Faktorët kryesorë që mundësojnë organizimin e procesit të Buxhetimit Gjikor brenda OPK-së

VULLNETI POLITIK DHE DREJTIMI POLITIK

Angazhim i nivelit të lartë të institucioneve publike administrative

Përmirësimi i kapacitetit teknik të nëpunësve civilë

Përfshirja e Aktorëve

Të dhënat e klasifikuara sipas gjinisë

(EIGE, 2019b, fq. 5)

Identiteti i OPK-ve formon perspektivën gjinore


- ❖ Historia
- ❖ Vlerat dhe misioni
- ❖ Organizimi dhe struktura
- ❖ Rrjetet gjinore
- ❖ Mjedisi i jashtëm
- ❖ Aftësitë e OPK-së

Identifikimi i aftësive kryesore të OPK -së

Aftësitë e
brendshme

Aftësitë
pjesëmarrëse

Origjina e Aktorëve



Early 18th century
Stakeholding exclusively part of gambling culture

Late 19th century
Primacy of the shareholder

1940s
Managers as trustees, balancing multiple communities

Early 1960s
'Stakeholder' identified as a concept

Late 1960s
Ansoff incorporates stakeholding into corporate strategy

Early 1980s
Freeman writes *Strategic Management: A Stakeholder Approach*

Mid-1990s
Tony Blair describes a stakeholder economy

2010s
Stakeholder Engagement starts to emerge as a managerial and professional discipline

Identifikoni dhe vlerësoni aktorët

Pasi të vendosni se cilët janë aktorët tuaj kryesorë, vendosini ata në një sfond interesi dhe ndikimi

Kjo ndihmon në përcaktimin se cilat grupe dhe individë kërkojnë më shumë përpjekje



Angazhimi i Aktorëve

Angazhimi i aktorëve është procesi përmes të cilit ne përfshijmë njerëz që mund të preken nga PBGJ-ja & BGJ-ja...

... ose ata të cilët mund të ndikojnë në zbatimin e tyre

Ekziston një ndryshim i madh midis komunikimit dhe angazhimit



- **Komunikimi** është ndarja e informacionit të njëanshëm.
- Përgjigjet e vetme të mundshme janë: "po", "jo" dhe nuk mund të bëni shumë për jo -të nëse nuk e dini pse ata po thonë jo.

Angazhimi i Aktorëve

Angazhimi është i dyanshëm

- Ofron informacion dhe kërkon të dhëna;
